



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2540 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.08.2025

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE

“MBI DRAFTIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN
2025-2028 NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ”

I mbajtur sot, më 25.08.2025.

Vendi: Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ora:13:00

Në takim marrin pjesë:

Mikel Qafa, Zëvendëskryetar Bashkie;

Elis Miria, Specialist për Këndin e BE dhe Projektet në Bashki.

Albina Prenga, Specialiste e IT në bashki;

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Të pranishëm në këtë konsultë janë këshilltarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të administratës së bashkisë, institucioneve vendore, shoqërisë civile, përfaqësues të diasporës dhe banorë të bashkisë.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit

Bashkiak Fushë-Arrëz, përshëndet dhe falenderon të pranishmit në takim si dhe bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjesës publike mbi “Draftin e Planit për Migracionin dhe në Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028”



Fjalën hapëse e mbajti **Mikel Qafa**,

Zëvendëskryetar i Bashkisë:

Të nderuar qytetarë, përfaqësues të institucioneve,
përfaqësues të diasporës dhe miq të pranishëm!

Sot kemi kënaqësinë të ndajmë me ju draftin e Planit për Migracionin dhe Diasporën 2025–2028, një dokument i rëndësishëm strategjik që synon të forcojë lidhjet e bashkisë sonë me qytetarët që kanë zgjedhur të jetojnë jashtë vendit, si dhe të adresojë sfidat dhe mundësitë që sjell migracioni. Migracioni ka prekur thuajse çdo familje të komunitetit tonë, duke krijuar sfida për zhvillimin social e ekonomik, por njëkohësisht duke sjellë edhe mundësi të reja përmes përvojës, dijes, investimeve dhe solidaritetit të diasporës sonë. Ky plan është përpjekja jonë për ta kthyer këtë realitet në një potencial zhvillimi të qëndrueshëm.

Nëpërmjet tij kemi parashikuar masa për forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me diasporën;

mbështetjen e migrantëve të kthyer për t'u riintegruar në komunitet;

nxitjen e investimeve dhe iniciativave të diasporës në vendlindje;

si dhe ruajtjen e identitetit dhe kulturës sonë tek brezat e rinj në mërgatë.

Ky proces nuk mund të jetë i plotë pa pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj. Prandaj dëgjesa e sotme është një mundësi e vyer për të pasuruar draftin me ide, rekomandime dhe propozime konkrete që vijnë nga përvoja juaj dhe nga kontakti i përditshëm me sfidat që ngrenë migracioni dhe diaspora. Jam i bindur se së bashku mund të ndërtojmë një plan vizionar dhe realist, që i shërben jo vetëm komunitetit tonë këtu, por edhe atij të shpërndarë nëpër botë.

Ju falënderoj për praninë dhe për angazhimin tuaj!



Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjese konsultative ku pjesëmarrja tregon se interesi juaj dhe padyshim besimi ndaj sektorëve të pushtetit vendor

po vjen duke u rritur. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë mendimet dhe rekomandimet tuaja lidhur draftin e Planit për Migracionin dhe Diasporën në Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028. Bashkia Fushë-Arrëz, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj në fushën e diasporës dhe migracionit, ligjit "Për veteqeverisjen vendore, i ndryshuar Neni 29/1 dhe akteve nënligjorë të tij, Strategjise Kombëtare për Diasporën Shqiptare, ligjit "Për te huajt", ligjit "Për shtetësinë", ligjin nr. 16/2018 "Për diasporën" i ndryshuar, grupi i punës hartoi draftin e "Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028".



Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh situatën aktuale, në të cilën nga njëra anë kemi migracionin gjithnjë në rritje drejt vendit tonë, si dhe migrantët e kthyer, si një komunitet me nevoja emergjente, të cilit duhet ti kushtohet vëmendja e duhur për të arritur një ri-integrim të qëndrueshëm të tij, nga ana tjetër qëndron diaspora, e cila është një resurs i

jashtëzakonshëm intelektual dhe ekonomik, si dhe potencial konkret për zhvillimin e vendit.

Diaspora e Fushë-Arrëzit është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Ky Plan veprimi synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Diasporës.

Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. E gjithë kjo do të realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e vet në qytetin e origjinës dhe anasjelltas.

Sa më sipër "Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028", përbën një plan masash konkrete, të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e migracionit dhe diasporës, të cilat

garantojnë përmbushjen e projekteve prioritare për integrimin e tyre dhe përfshirjen në jetën sociale ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Me miratimin e këtij plani synohet gjithashtu incentivimi i investimeve nga diaspora në komunitetet e tyre të prejardhjes, si dhe organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet implementimit të projekteve të perbashkëta, me qëllim zhvillimin social-ekonomik të qytetit.

"Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028" është një dokument i rëndësishëm, i cili pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale, duke e shndërruar bashkinë në një portë të hapur për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës së Fushë-Arrëzit në jetën ekonomike dhe social-kulturore të qytetit, si dhe një suport dhe ndihmë konkrete për migrantët e kthyer.



Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

Meqenëse nuk ka diskutime dëgjesa mbyllet këtu duke ju falenderuar për përkushtimin dhe angazhimin tuaj!

SEKRETAR
Naze SELIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN
2025-2028, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Ape	Doda	Fush - Arrës	QSNNN	
2.	Jone	Memo	Fush - Arrës	QSNNN	
3.	Mirjeta	Trroku	F. A.	QSNNN	
4.	Aferdita	Brakaj	F. Arrëz	Edukatore	
5.	Silvana	Gjergji	Kryezi	Edukatore	
6.	Edmonda	Delia	F - Arrëz	Edukatore	
7.	Age	Qafa	F - Arrëz	Drejtoreshë	
8.	Dalina	Curri	F.A	QSNNN	
9.	Dalina	Prenga	F.A	QSNNN	
10.	Gazmen	Likaj	F - Arrëz	Mesues	
11.	MERITA	ESINAT	F - ARREZ	METODISTE QKF.	
12.	Sefer	Delia	F. Arrëz	Metodist QKF.	
13.	Keisibela	Sadrija	F. Arrëz	Metodiste QKF	
14.	Dava	Alla	F - Arrëz	Metodiste QKF	
15.	Monte	Wikel	F - Arrëz	QSNNN	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN
2025-2028, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Dava	Alia	Fushë - Arrëz	Metodiste QKF	
2.	Keisibela	Sadrija	F - Arrëz	Metodiste QKF	
3.	MERITA	EGJINAZ	F - ARRËZ	METODISTE QKF	
4.	Gjeneri	Delia	F. Arrëz	Metodiste QKF	
5.	ANDMIN	ASHA	FA	DAPK	
6.	Pashli	Qrena	FA	Jegfsh	
7.	WIKAR	MILKUR	F. VARRER	JMI, PIESA	
8.	Gjido	St. Guri	Fushë-Arrëz	Kadaster	
9.	Albin	Enxelli	Fushë-arrëz	Sp. orsim	
10.	Marie	Moringj	F-Arrëz	Sp. Migrimit	
11.	Albina	Prenga	Fushë-Arrëz	Specialiste IT	
12.	Flodiana	Pjetra	Fushë - Arrëz	P. Gjendja Civile	
13.	Gjoko	Nikolli	Fushë - Arrëz	Bashkia	
14.	Redona	Hasani	Fushë - Arrëz	Regj. Juriste	
15.	Desara	Koca	Fushë - Arrëz	Sp. Burimeve Njerëzore	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
DRAFTI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN
2025-2028, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Sidorela	Katroshi	Bashkia F-A	Drejtore e Gestive Sociale	
2.	Valbona	Milla	Bashkia F. Arrëz	Specialiste K.B.	
3.	Naze	Selimi	Bashkia F-Arrëz	Shkretore KB	
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					